

RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

Për kryerjen e auditimit e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga "Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet" për vitin kalendarik 2016

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Subjektit "Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet" Tiranë

Me cilesine e Audituesit Ligjor (Ekspertit Kontabël te Regjistruar), të caktuar me Vendimin nr.196 datë 03/05/2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve " Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël për të kryer auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga Partitë politike për vitin kalendarik 2016, për realizimin e auditimit kemi kryer procedurën e mëposhtme:

Mbas nënshkrimit të Kontratës nr.5484/2 datë 13/09/2017 lidhur me KQZ për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga Partitë politike për vitin kalendarik 2016, morëm kontakt me Kryetarin e Subjektit "Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet" z. Gaqo Apostoli, të cilin e bëmë me dije me :

- Vendimin nr.196 datë 03/05/2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për të bërë të mundur realizimin e auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2016.
- Kontratën nr.5484/2 datë 13/09/2017 lidhur me KQZ për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga Partitë politike për vitin kalendarik 2016

Njëkohësisht derguam njoftim zyrtarisht, për të filluar procedurat e auditimit.

Drejtuesit e Subjektit "Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet" na kanë konfirmuar zyrtarisht se nuk kanë përfituruar fonde për vitin 2016, dhe nuk kanë shpenzime fondesh për këtë vit. (deklarata bashkangjitur)

Si konkluzion për shkak se procedurat e mësipërme nuk përbëjnë auditim dhe as rishikim të bërë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të auditimit ne nuk mund të shprehim asnjë opinion për fondet e përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit 2016 nga "Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet".

Auditues ligjor (Ekspert Kontabël e Regjistruar)

Tiranë me 12/10/2017

ANITA PULAJ



BLV. Gjergj Fishta, Pall G& P, hyrja II, Kati II, mbi Credins Bank, Tiranë,
Nr. Kontakti Cel.0692087743 , e-mail pulaj_anita@yahoo.com

Nr. 51. P. 26.

DEKLARATE

Pasi u njohem me Vendimin e Komisionit Qendror te Zgjedhjeve Nr. 126 date 20.09.2016, per Auditimin e Fondeve te Perfituara dhe Shpenzuar nga Subjektet Politike per vitin kalendarik 01.01.2016 - 31.12.2016,

DEKLAROJME

Partia "Aleanca per Demokraci dhe Solidaritet"/ADS nuk ka perfituar asnje lloj fondi sic parashikohet ne dispozitat ligjore dhe ne statutin e partise ne perputhje me Ligji nr.8580, dt.17.02.2000 "Per partite politike", i ndryshuar dhe Ligjin 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Per vitin 2016 deklarojme qe nuk kemi asnje kontribut anetaresimi, sponsorizimi, dhurimi e te tjera sic parashikohet nga dispozitat ligjore.

PASQYRA E TE ARDHURAVE TE PARTISE ALEANCA PER DEMOKRACI DHE SOLIDARITET PER VITIN 2016		
Nr	Burimet e Financimit	Sipas raportit financiar
1	Nga buxheti i shtetit	0
2	Nga fondet e vet Partia Aleanca per Demokraci dhe Solidaritet	0
3	Nga Donatoret(sponsorizime)	0
	-me banke	0
	-me arke	0
	-ne natyre	0
	Gjithsej te ardhura	0
PASQYRA E SHPENZIMEVE TE PARTISE ALEANCA PER DEMOKRACI DHE SOLIDARITET PER VITIN 2016		
1	Shpenzime	0
	Dieta	0
	Gjithsej shpenzime	0

Kete Deklarate dhe Bilancin e vitit 2016 ja paraqesim ekspertes kontabel Anita PULAJ, e cila eshte caktuar te kryej auditimin e fondeve te perfituara dhe shpenzuara nga "Partia Aleanca per Demokraci dhe Solidaritet" per vitin 2016, sipas Vendimit perkates te KOZ-se. Per mungese fondeesh, nuk mund te paguajme koston e auditimit te bilancit te vitit 2016 te partise sone ADS.

Gaqo APOSTOLI

Kryetar



Tirane, me 06.10.2016